

THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIMIN  
E PROJEKTEVE HULUMTUESE NË  
SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

SFIDA PËR  
HULUMTUESIT E RINJ  
**5 – PROJEKTET E GJELBËRTA**

SHKOLLAT FILLORE PËRFITUESE



VENDI	EMRI I SHKOLLËS	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
<b>f.Kamjan</b>	<b>SHFK „Sabedin Bajrami”</b>	<b>Aksione Eko për një të ardhme të gjelbër</b>	Qëllimi kryesor hulumtues i nxënësve që do të përfshihen në këtë projekt është pse dhe si ndikojnë burimet e rinovueshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut. Ata do të kryejnë hulumtimin përmes zëvendësimit të energjisë elektrike me burime efikase të rinovueshme të energjisë. Me vendosjen e llambave diellore, nxënësit në shkollë do të konfirmojnë hipotezën se trendi i ri në botë është zëvendësimi i burimeve të pa rinovueshme (qymyri, nafta, gazi natyror) me burime të rinovueshme (energja e diellit, energjia e erës, energjia e ujit dhe biokarburantet) sepse përveç dëmtimeve të mjedisit, siç janë ndryshimet klimatike në botë, janë të dëmshme edhe për shëndetin e njeriut (kancerogjene).
<b>Çuçer Sandevë</b>	<b>SHFK "Aleksandar Urdarevski"</b>	<b>Nga mbeturinat në kompost</b>	Ideja bazë e projektit është krijimi i një Komposti Grupor dhe inkurajimi i nxënësve, prindërve të tyre dhe popullatës lokale që të marrin pjesë në procesin e kompostimit, d.m.th. në procesin e përzgjedhjes së mbetjeve, mbledhjes së mbetjeve organike dhe përpunimit të tyre në kompost. Qëllimi kryesor i projektit është ndërgjegjësimi për klasifikimin e mbetjeve për mbrojtjen e mjedisit, i cili do të parandalojë që mbetjet organike, të qelqit, plastikës dhe letrës të përfundojnë në landfille me kapacitet të kufizuar, ku kalben dhe ndotin ujin, ajrin dhe tokën.
<b>Karbinca</b>	<b>SHFK "Strasho Pinxhur"</b>	<b>Nga mbetjet e tekstit në një produkt të ri</b>	Projekti do të synojë të rrisë ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë për ripërdorimin e mbetjeve të tekstit nga rrobat e vjetra ose nga konfeksionet e tekstit. Nëpërmjet projektit nxënësit do të kryejnë hulumtime statike mbi sasinë e mbetjeve tekstile të prodhuara nga industria e tekstit, mbi llojet e ndryshme të tekstileve si dhe mbi procesin e dekompozimit të tyre në natyrë. Qëllimi përfundimtar është ripërdorimi i mbetjeve të tekstit duke aplikuar teknologji inovative.
<b>Strugë</b>	<b>SHFK "Vëllezërit Miladinovci"</b>	<b>Pastrimi i ujit në liqenin e Ohrit me një prototip të një anijeje micro bit</b>	Nevoja për zbatimin e këtij projekti është pastrimi i njollave toksike nga sipërfaqet ujore, mbetjeve të ngurta lundruese dhe mbetjeve në fund të deteve, liqeneve apo lumenjve, gjë që ka qenë gjithmonë problem. Ky është një proces i vështirë, mjaft i shtrenjtë dhe duhet të jetë i plotë. Qëllimi i këtij projekti hulumtues është pastrimi i këtyre njollave, pastrimi i mbetjeve të ngurta në ujë. Nxënësit së bashku me mentorët e tyre do të krijojnë një anije – prototip për pastrim, i cili do të zgjidhte problemin e njollave dhe mbeturinave në liqenin e Ohrit. Në këtë mënyrë, duke pastruar rregullisht liqenin, pastrimi do të bëhet më i thjeshtë dhe do kushtojnë më pak. Anija, e cila do të lëvizë me telekomandë, do të ketë tre funksione kryesore: thithjen e njollave toksike, mbledhjen e mbetjeve të ngurta lundruese dhe grumbullimin e mbetjeve në fund të ujit të liqenit të Ohrit.

VENDI	EMRI I SHKOLLËS	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
<b>Shkup</b>	<b>SHFK "Kiro Gligorov"</b>	<b>Për të zhvilluar mendjen e një fëmije, së pari duhet të mbillet farë</b>	Qëllimi kryesor i projektit është krijimi i një kopshti botanik shkollor, ku nxënësit praktikisht do të njihen me karakteristikat dhe mënyrat e rritjes së llojeve të rëndësishme të bimëve mjekësore që janë të rëndësishme si për shëndetin ashtu edhe për studimin e biodiversitetit në R. e Maqedonisë së Veriut. Aktivitetet kryesore të projektit janë përfshirja e nxënësve në një proces hulumtues, të cilët duke zbatuar aftësitë e programimit me ndihmën e mikrobitit, do të njohin mënyrën e rritjes së bimëve mjekësore (intensiteti i dritës, përbërja kimike dhe lagështia e tokës, ndikimi i muzikës në rritjen e bimëve) dhe përdorimin e bimëve për të bërë çajra.
<b>Dellçevë</b>	<b>SHFK "Vanço Prke"</b>	<b>Gota që rriten në degë</b>	Përmes këtij projekti nxënësit do të hetojnë nëse fruti i bimës së kungullit të ujit që rritet në vendin tonë dhe që është përdorur në të kaluarën si enë, në mënyrë moderne të kultivohet në një formë të caktuar enë duke përdorur kallëpe dhe të përdoret si i tillë në jetën e përditshme. Përdorimi i materialeve të tilla jo vetëm që do të reduktojë përdorimin e plastikës, por vetë materialet nuk janë të dëmshme për prodhimin edhe pas përdorimit. Kur ato prodhohen (rriten), përftohet më shumë oksigjen dhe bimët dhe frutat (enët) mund të hidhen në natyrë ose të kompostohen.
<b>Gostivar</b>	<b>SHFK "Çajla"</b>	<b>Projektet e gjelbra</b>	Qëllimi kryesor i këtij projekti është të theksojë rëndësinë e jetës së bimëve për një mjedis të shëndetshëm, ruajtjen e një mjedisi të pastër, si dhe reduktimin e mbetjeve përmes riciklimit. Nxënësit fillimisht në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me arsimtarët nga rezultatet e hulumtimit nga burime të ndryshme kuptojnë se: bimët që përdorin dioksid karboni (CO2) dhe ujin që marrin nga atmosfera gjatë fotosintezës prodhojnë lëndë ushqyese dhe oksigjen (O2). Duke identifikuar dhe njohur bimët si prodhuesit kryesorë të oksigjenit përmes punës në terren, përgatitet një herbarium.

VENDI	EMRI I SHKOLLËS	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
Shkup	SHFK "11 Tetori"	<b>Ricikloni gazetën, mbillni lule! Zbukuroje gjithë botën!</b>	Hulumtimi dhe vëzhgimi do të realizohet nga 10 nxënës “hulumtues të rinj” të cilët do të regjistrojnë të gjithë procesin e zhvillimit në fletoren e tyre të punës “Ditari” dhe do të ndajnë aktivitetet e tyre nëpërmjet përdorimit të gazetave të vjetra, për të përcjellë idenë e tyre te nxënësit e tjerë si një thirrje për zgjimin e arsyes ekologjike, mbrojtjen dhe përmirësimin e natyrës. Duke përdorur metodat e përmendura, çdo gazetë, pasi të lexohet, mund të ripërdoret, të bëhet barishte dhe të rrisë nivelin e gjelbërimit. Në të njëjtën kohë, në këtë mënyrë zvogëlohet sasia e mbetjeve që përfundojnë në landfille. Hulumtuesit e rinj do të riciklojnë në mënyrë të pavarur gazetën, do të bëjnë një përzgjedhje të farave të ndryshme që do të vendosen/lidhen në vetë gazetën e ricikluar, e cila do të përdoret më tej për të bërë letra, gazeta shkollore dhe fletushka me mesazhe eko.
Shkup	SHFK "Kiro Gligorov"	<b>Mesazhe të gjelbërta për Gjelbërdonin</b>	Me zbatimin e këtij projekti, nxënësit e shkollave fillore në mënyrë kreative dhe interesante do të hulumtojnë, riciklojnë dhe prodhojnë vepra dhe krijime kreative. Qëllimi kryesor është të bëhet letër nga gjethet dhe bari i mbledhur. Nëpërmjet hulumtimit dhe përpunimit, ata do të bëjnë një album nga gjethet e mbledhura.
Strumicë	SHFK "Dame Gruev"	<b>Përcaktimi i varësisë ndërmjet rritjes së bimëve dhe përqendrimit të plehrave natyralë dhe vërtetimi i fotosintezës</b>	Nxënësit do të hetojnë rritjen e bimëve në varësi të përdorimit të përqendrimeve të ndryshme të plehrave natyrore - plehut organik të fushës dhe malit, si dhe ndikimin e dritës në fotosintezë (formimin e niseshtës). Ky projekt është një praktikë e shkëlqyer që fëmijët që në moshë të re të fitojnë shprehi të shëndetshme dhe njohuri se si të mbrojnë mjedisin ku jetojnë. Kjo shkollë është pjesë e rajonit juglindor të R. Maqedonisë, ku në masë të madhe prodhohen prodhime bujqësore dhe hortikulturore, gjë që shkakton ndotje të shpeshtë të sipërfaqes së punueshme me pesticide, herbicide, plehra artificiale etj. D.m.th. produkte të prodhuara kimikisht që dëmtojnë shumë organizmin e njeriut duke i gëlltitur ato në mënyrë indirekte çdo ditë përmes ushqimit.